

Keqkuptimet Kosovë-Shqipëri

Albanologu Robert Elsi u lind në Vankuvër të Kanadasë më 1950. Pasi studioi për filologji klasike dhe gjuhësi në Universitetin e Kolumbisë Britanike, më 1972 vjen në Evropë për t'i vazhduar studimet se pari në Gjermaninë Perëndimore e më vonë në Paris e në Dablin. Në Universitetin e Bonit mbrojti doktoraturën më 1978. Ky ka qenë edhe viti kur ai pati kontaktet e para me Shqipërinë. Që prej asaj kohe, me një shqipe të mësuar gati perfekte, Elsi është një nga albanologët më të spikatur dhe me një prodhimtari botuese të admirueshme për sa i takon fushës së letërsisë dhe gjuhësisë shqiptare. Ai ka publikuar me dhjeta studime dhe libra, disa në gjuhën shqipe, por kryesisht në gjermanishte dhe anglishte. Në Shqipëri sapo ka dalë libri me vëzhgime mbi letërsinë dhe kulturën shqiptare bashkëkohore, *“Një fund dhe një fillim”*, dhe ndërkohë në Nju Jork është botuar vepra e tij e deritashme më e madhe, *“History of Albanian Literature”* në dy vëllime dhe ndofta vepra me e plotë e historisë së letërsisë shqipe botuar deri më sot. Zoti Elsi e jep këtë intervistë posaçërisht për *Zërin*.

[EB]: Z. Elsi, si rezultat i punës dhe i kontakteve të deritashme me Shqipërinë, në cilin raport ndodheni aktualisht me këtë vend, sidomos me letërsinë dhe kulturën e këtij vendi, të cilën ju e keni ndjekur gjatë dhe së cilës i dedikohet edhe botimi juaj i fundit i historisë së letërsisë shqipe?

[RE]: Se pari dua të them se nuk pretendoj të kem shkruar një histori të letërsisë shqipe për shqiptarët, por për botën e jashtme. Këtë vepër unë e kam shkruar anglisht. Në këtë aspekt unë e shoh punën time si një orvatje për të transmetuar njohuritë mbi kulturën shqiptare në botën e jashtme. Për një kohë të gjatë Shqipëria u izolua dhe bota harroi se po ekzistonte. Përpiqem të punoj që kjo kulturë të bëhet më e njohur dhe sigurisht kjo arrihet përmes përkthimeve të veprave që trajtojnë aspekte të ndryshme të kulturës dhe të jetës shqiptare.

[EB]: Sa kohë keni punuar në veprën tuaj të fundit, që për nga lloji i vet është edhe më voluminozja, por edhe më e plotë.

[RE]: Ishte një punë vërtet e madhe pesëvjeçare për ta përgatitur këtë vepër. Por botimi u zgjat shumë, rreth tre vjet, për arsye të ndryshme teknike. Libri doli në qershor të këtij viti, në Nju Jork. Mendoj se ai do të bënte efekt më të madh sikur të shihte dritën e botimit në kohë e duhur, pikërisht në fillim të vitit 1990. Por, tashmë shumë gjëra dihen për Shqipërinë, dhe jashtë, ndofta një pjesë e kuriozitetit është tretur. Megjithatë, shpresoj se të huajt do të gjejnë një pasqyrë të re të vlerësimit të letërsisë dhe kulturës shqipe.

[EB]: Ç’ mendim keni për *“Historinë e letërsisë shqiptare”* të vitit 1983?

[RE]: Duke qenë se më parë s’ka pasur asnjë histori të letërsisë shqiptare, mendoj se është një përpjekje dhe çdo përpjekje duhet vlerësuar. Por, nga ana tjetër, ajo është bërë me shumë kufizime politike. Rryma zyrtare letrare e letërsisë shqipe është përfshirë, por

ana tjetër, ajo jozyrta, nuk është futur, kështu që e ka lënë këtë vepër të paplotë. Këtu përfshij jo vetëm letërsinë e ndaluar politikisht, por edhe atë të Kosovës, arbëreshëve, etj.

Por, këtu është mjaft e çuditshme se ekziston një mentalitet i çuditshëm dhe jo vetëm në fushën e kulturës, por kudo, edhe në politikë. Në të gjithë botën përmenden dhe flitet për ata të cilët kanë bërë diçka, përfshirë këtu edhe rivalët, duke i lavëruar apo kritikuar, ndërsa këtu në Shqipëri është një tendencë për të harruar, për të varrosur atë që nuk e do. Kjo ka ndodhur edhe me Historinë e letërsisë të vitit 1983, atje jo vetëm që nuk janë kritikuar shumë autorë të vjetër, që rregjimi i atëhershëm s'i ka dashur, si Fishta, Konica, Koliqi, Camaj etj, por ata edhe më keqë janë injoruar, harruar, zhdukur. Kjo tendencë më duket shumë e çuditshme dhe shumë shqiptare njëkohësisht.

Për këtë përcaktim më ndjek edhe një kujtim jo shumë i bukur në vitin 1989, kur unë isha ftuar me një ftesë të Akademisë së Shkencave, për të mbajtur një kumtesë në një seminar në Tiranë. Në kumtesën time bëja fjalë për dy përkthime të bëra nga Arshi Pipa dhe tjetra nga Martin Camaj. Vetëm i citova, pa bërë asnjë koment, por kur mbarova u duk sikur në sallë kishte hyrë një fantazmë. Edhe përmendja e emrave të tyre ishte një herezi e madhe, të cilën unë nuk mundja të kuptoja dot. Edhe sot s'mund të kuptoj dot këtë mënyrë, e cila, siç thashë, nuk ka të ngjashëm në asnjë vend tjetër, me sa di unë.

[EB]: Një kuriozitet i vogël. Cilat ishin kontaktet e parë me Shqipërinë?

[RE]: Kjo ka ndodhur në Paris, ku unë kam studiuar. Në metronë e këtij qyteti unë pashë për herë të parë një shqiptare që lexonte shqip. Ajo po lexonte veprat e Mao Ce Dunit. Si fillim ishte vetëm kaq. Më vonë, më 1978, isha i ftuar nga Boni, në një konferencë. Profesori im ishte austriak, që do të thotë se s'ishte një imperialist i madh, se dihet që Austria ishte një vend neutral. Ai mori një ftesë nga Akademia e Shkencave këtu dhe, së bashku me ne studentët, bëri një vizitë në këtë vend. Ishte një gjë mjaft interesante për ne, kur për herë të parë pamë parullat socialiste. Pastaj interesimi për Shqipërinë u shtua. Nisa të mësoja gjuhën në një mënyrë autodidakte, që ishte vërtet e vështirë, duke pasur parasysh se shqipja është gjuha e vështirë. Për herë të parë isha në Kosovë (Prishtinë) në seminarin e parë të gjuhës, por e kuptova shpejt se s'mund të mësoja dot mirë shqipen në Prishtinë. E folura e rrugës, krejt e veçantë dhe e ndryshme, më bëri konfuz dhe mezi merresha vesh. Më pas i kam ndjekur të gjithat seminarët e gjuhës dhe letërsisë që zhvilloheshin atje, por mësimin tim të shqipes ia dedikoj më shumë vetvetes, sepse siç iu thashë, kam mësuar si një autodidakt.

[EB]: Meqenëse ju përmendet seminarët e gjuhës, ç'mendim keni për seminarin e fundit që u zhvillua në Tiranë?

[RE]: U gëzova që ky seminar u ringjall pas disa vitesh fjetjeje. Mendoj se ai u organizua shumë mirë.

[EB]: Si e shihni ju bashkëpunimin e shkencëtarëve shqiptarë të Shqipërisë me ata të Kosovës. Ka pengesa mes tyre?

[RE]: Pa dyshim që pengesa kryesore është ajo politike. Ende kufiri nuk është hapur. Është e njëjtë gjendje mes këtyre dy pjesëve, sikurse në kohën e komunistëve. Dhe është një kohë kur më shumë se kurrë, kontaktet mes intelektualëve, shkrimtarëve dhe shkencëtarëve shqiptarë janë të domosdoshme që do të zbusnin keqkuptimet, do t'i hapnin më shumë rrugë bashkëveprimit me njëri-tjetrin. Dhe, në fakt, keqkuptime ka shumë. Kur shoh këtë urrejtjen që ekziston shpeshherë për kosovarët, me duket e çuditshme, aq sa ndonjëherë mendoj se janë dy popuj të ndryshëm.

[EB]: Një mungesë e hershme informacionit?

[RE]:Po, pa dyshim edhe kjo. Në të gjitha rastet, kontaktet dhe njohja do t'i shpëtojnë të dyja brigjet shqiptare nga keqkuptimet.

E intervistoi: Elsa Ballauri.

[botuar në / published in: revistën *Zëri*, Tirana, 25 nëntor/November 1995, p. 82.]